REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.26060prot. Shkodër, më 21.10.2026

VENDIM
Nr. 82, datë 19.10.2026

PËR MIRATIMIN E SHTESËS SË PLANIT DHE NDRYSHIMIT NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË MIRATUAR ME VKB NR. 84, DATË 18.12.2025, "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR", TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; të ligjit nr. 87/2025, datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar; VKM-së nr. 325, datë 29.05.2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; VKB-së nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar; VKB nr. 37, datë 30.04.2026 "Për miratimin e shtesës dhe ndryshimit të planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 'Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër'", të ndryshuar; vendimit të Kryetarit nr. 310, datë 08.10.2026 "Për miratimin e rishpërndarjes së projekteve të investimeve brenda të njëjtit program, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese për vitin 2026", si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratohet shtesa e planit të të ardhurave në zërin ekonomik 7035052, në vlerën 23,807,390 lekë, në Buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.

2. Të miratohet shtesa e planit të zërit të shpenzimeve kapitale të trupëzuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të

vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, si më poshtë:

Tabela 1: Shtesë plani nga mbledhja e të ardhurave më tepër për vitin 2026

Në lekë

Nr.	Kap	Programi	Projekti	Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime kapitale të trupëzuara	Institucioni likuidues
1	5	AG141	P066AAM	P.AG141.Q6.O1.A3 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit. (Ndërtim i banesave për strehim social / blerje banesa në treg të lirë / përshtatje e objekteve të dala jashtë funksioni për strehim etj.). (Shtesë)	23,807,390	Bashkia Shkodër
				TOTALI	**23,807,390**	

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 30 vota

Vota Pro	30
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0

Zbardhur me datë 20.10.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULI